



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.557/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi Kryesues dhe Ferki Xhaferi e Zyhdi Haziri anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Durim Zumeri me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.557/2021 i paraqitur nga Durim Zumeri, me vendbanim në Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 30.08.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Durim Zumeri me vendbanim në Gjermani, përmes së cilës ka kërkuar rishqyrtimin e ankesës pasi që sipas tij është keqkuptuar dhe nuk është shqyrtuar kërkesa e tij e mëparshme për të cilën është vendosur më parë nga PZAP me vendimin Anr.536/21. I njëjti pretendon se në apelin e paraqitur nuk ka kërkuar që Nevzat Zumeri të përfshihet në listën e votimit nga jashtë ashtu siç është marrë vendim për refuzim për Nevzat Zumerin, por ka kërkuar që për shkak të gabimit teknik në aplikim mos të anulohen edhe dy aplikime të cilat janë të rregullta për Kadrije Zumerin dhe Admir Zumerin. Parashtruesi i apelit ka kërkuar që edhe njëherë të shqyrtohet ankesa për shkak të gabimit që është bërë në aplikim për Nevzat Zumerin dhe të mos anulohen aplikimet për Kadrije Zumerin dhe Admir Zumerin pasi që janë dëshmitë e aplikimit të rregullt të datës 18.08.2021.

Parashtruesi i apelit, apelit i ka bashkangjitur emailin nga KQZ, formularët e aplikimit për Admir Zumerin dhe Kadrije Zumerin së bashku me dokumentet identifikuese/ letërnjoftimet.

Me datë 30.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 31.08.2021 në ora 10:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se lidhur me këtë apel të parashtruar nga Durim Zumeri është përgjigjur edhe më parë dhe se me datë 18.08.2021, janë dërguar tri aplikacione nga Durim Zumeri për Kadrije Zumerin, Admir Zumerin dhe Nevzat Zumerin dhe se arsyet e refuzimit për tu futur në listat e votuesve jashtë Kosove për dy personat që janë edhe objekt shqyrtimi i këtij apeli Kadrije Zumeri dhe Admir Zumeri është bërë për arsye se me datë 22 gusht 2021, janë kontaktuar numrat e telefonit të tyre mirëpo në numrat kontaktues të tyre janë lajmëruar persona krejtësisht tjerë andaj edhe numrat e dhënë në aplikacion nuk korrespondojnë me aplikuesit sikurse janë dhënë të dhënat në aplikacionet e tyre dhe se gjatë kontaktimit në numrat e dhënë në aplikacion personat që janë lajmëruar kanë konfirmuar se nuk kanë aplikuar personalisht andaj edhe aplikacionet e tyre janë refuzuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë periudhës për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës për aplikuesit familjar të tij Kadrije Zumeri dhe Admir Zumeri nuk ka bërë aplikimin sipas kriterëve të kërkuara nga KQZ, kjo shihet nga përgjigja e KQZ-se e cila thekson se janë kontaktuar numrat e telefonit të tyre mirëpo në numrat kontaktues të tyre janë lajmëruar persona krejtësisht tjerë andaj edhe numrat e dhënë në aplikacion nuk korrespondojnë me aplikuesit sikurse janë dhënë të dhënat në aplikacionet e tyre dhe se gjatë kontaktimit në numrat e dhënë në aplikacion personat që janë lajmëruar kanë konfirmuar se nuk kanë aplikuar personalisht andaj edhe aplikacionet e tyre janë refuzuar andaj i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: **“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”**, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: **“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”** dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Paneli rithekson se KQZ-ja, me rastin e vlerësimit të aplikimeve ka bërë verifikimin e aplikacionit, dhe rrjedhimisht kur ka konstatuar në numrat e telefonit që rezultojnë si në aplikacionin e Kadrije dhe Admir Zumeri, ka rezultuar se personat që janë lajmëruar nuk janë ata persona sikurse me të dhënat e tyre në aplikacion, andaj paneli vlerëson se KQZ-ja me të drejt nuk i ka përfshirë në listën e votuesve aplikimet e tilla nga se për tu mundësuar përfshirja në listat e votuesve jashtë vendit duhet që të plotësohen kushtet ligjore, rrjedhimisht KQZ-ja ndër kushtet për procesin e zgjedhjeve ka përcaktuar edhe verifikimin përmes kontaktit të personave që vet në aplikimin e tyre kanë dhënë numrat kontaktues, gjë që nga përgjigja e KQZ-ës rezulton se në verifikim kanë rezultuar se nuk janë ata persona.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura si më lartë edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret ankuesi thënie të tij nuk i mbështetën në asnjë provë konkrete por se të njëjtat janë supozime dhe se këto pretendime ankuesi nuk i argumenton me asnjë provë.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtruar nga Durim Zumeri nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e pretenduar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 557/2021 më datën 01.09.2021

Kryesuesi i Panelit

Burim Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.